

TË JETOJMË DHE TË NDJEKIM

Letra e Ministrave gjeneralë françeskanë

REGULA NON BULLATA
1221 - 2021



Të gjithë fretërve të Urdhrit të parë

me rastin e gëzueshëm të tetëqindvjetorit të Rregullës së pavulosur,
ne Ministrat gjeneralë u dërgojmë këtë letër.

Për të përkujtuar me mirënjohje.

Për të përtërirë me pasion ndjekjen tonë të Zotit Jezus në formën e jetës së frat
Françeskut për Kishën dhe botën si fretër minorë.

Në lavd të Hyjit, «që është e gjithë e mira, e mira e vërtetë dhe
më e madhja e mirë» (RrP XXIII, 9).

PËR TË FILLUAR

Një tjetër përvjetor... Që të mos jetë vizita e detyruar në një muze!

Në vitin 1221 po përfundonte një prej shumë "historive" që, në traditën e krishterë, kanë pasur si rezultat përfundimtar prodhimin e një teksti të quajtur "rregull". Cila është "gjinia letrare" në fjalë? Neve fjala "rregull" ka shumë mundësi të na ngjallë një shqetësim të brendshëm vetëmbrojtjeje, sepse na kujton, në mënyrë pak a shumë të vetëdijshme, diçka të caktuar dhe skematike, ndoshta edhe të pafrytshme. Po ta shohim mirë, nuk është kështu. Në të vërtetë, duke lexuar Rregullën e pavulosur kemi ndjesinë e horizonteve që hapen, e perspektivave që hapin dyert e shpirtit dhe bëjnë që në zemër të hyjë ajër i freskët: në largësi prej 800 vjetësh!

Po, 800 vjet kanë kaluar dhe është i pashmangshëm kremtimi i një "përvjetori". Edhe këtu, menjëherë, një tjetër ndjenjë – këtë herë kryengritjeje – lind në ne: "Edhe një përvjetor tjetër! Për çfarë do të duhet?". Le të bëjmë një përpjekje: të mos i përgjigjemi që në fillim kësaj pyetjeje – "për çfarë duhet një përvjetor?" – por le ta lëmë atë në sfond. Të provojmë ta shmangim rrezikun që ta kremtojmë këtë rast me një prirje të ngjashme me atë të atij që viziton një muze pa u prekur prej tij, me një kureshtje të vakët turistike, pa më të voglën dëshirë për të përjetuar diçka të gjallë; ndoshta vetëm sepse "duhet", sepse "ai muze është i famshëm". Le të bëjmë rolin e "turistëve seriozë", që në një muze hyjnë duke e ditur se kryeveprat e soditura nuk do t'i lënë, më pas, ashtu siç kanë hyrë. Pra, le të rrimë para veprës së artit që është *Rregulla e pavulosur*; eh, një vepër pa datë dhe pa autor!

NË DËGJIM TË VAZHDUESHËM...

Pjesë jete sipas Ungjillit në Rregullën e pavulosur

Në transmetim të drejtpërdrejtë, pa datë dhe pa autor

Pikërisht kështu! Jemi duke folur për një vepër që nuk ka një datim të përpiktë e të saktë; ose, më mirë të themi: duhet të kujtohen shumë data, data të ndryshme për pjesë të ndryshme të tekstit. Viti 1221 është momenti në të cilin procesi ndalet, "data e fundit", le të themi kështu. Po autori a është shën Françesku? Me siguri që është ai që bën t'i rrahë zemra Rregullës, ai që injekton në përbërjen e saj limfën jetësore të Shpirtit. Por është më mirë të themi se bëhet fjalë për një "rregull tërësie", për një vepër të menduar dhe të hartuar në dialog me fretërit dhe me faktet. Shumë më përpara në kohë, Françesku i Asizit që ndër ata që kanë ditur t'i japin zë njërit prej parimeve tejet efikasë të papës Françesku: «Realiteti është më lart se ideja» (Evangelii Gaudium, nr. 231-233). Në të vërtetë, nuk kemi në duar një tekst normativ të shkruar në tryezë, por diçka që ka lindur në dialog me jetën; madje, para së gjithash është një "copë jete" më shumë se sa një "copë letre". Fjala e shkruar në fakt përpiket t'u japë përgjigje pyetjeve të lindura prej dëgjimit të vazhdueshëm të realitetit konkret. Madje, në Rregullën e pavulosur shohim gjenialitetin e atij që ka ditur të kapë "në transmetim të drejtpërdrejtë" pyetje të vërteta dhe të japë përgjigje efikase. Po, zgjuarsia shumë herë gjendet në këtë: në aftësinë për të kapur pyetje qendrore, jo abstrakte, por ato më të ndjeshmet dhe për të ndier "në lëkurë të vet", personalisht; për t'u dhënë këtyre pyetjeve përgjigje të cilat janë në gjendje të bindin, "bindëse" jo vetëm sepse "të drejta" për atë moment, por edhe sepse kanë ditur të bindin

të tjerë, përgjatë shekujve, për t'u përgjigjur me të njëjtën gjatësi vale. Pas tetëqind vitesh jemi ende këtu, për t'u përpjekur të përgjigjemi në sintoni me ato intuita, sepse jemi "të bindur" se ia vlen!

Ajo që të bën përshtypje nga kjo vepër arti që është *Rregulla e pavulosur*, është sidomos karakteri i saj i apasionuar. Duke e lexuar, kuptohet menjëherë se nuk jep disa rregulla për të bërë gjëra, por përpiket të përvijojë udhëzime për të jetuar marrëdhënie. Nuk është një tekst për skribë, por për nxënës (krh. Mt 13,52). Dhe marrëdhënia vendimtare që i liron në maksimum energjitë jetësore është ajo me Zotin Jezus, i shijuar me të vërtetë si thesar për jetën personale. I shijuar me të vërtetë! Trup e shpirt! E dimë: fillimi i Rregullës së pavulosur deklaroi qartazi se rregulla dhe jeta e fretërve minorë është «të ndjekin mësimin dhe gjurmët e Zotit tonë Jezu Krishtit (RrP I,1)», të jetojnë Ungjillin. Dhe kapitulli pas kapitulli paraqitet një seri e tërë udhëzimesh – nganjëherë të përmbledhura, herë të tjera të shprehura si me zemër në dorë – me qëllim që ky Ungjill të jetohet; dhe për ta jetuar atë shën Françesku na fton në shumë mënyra që të japim gjithçka, të lirohemi prej asaj që na pengon. Sigurisht, por vetëm nëse na ka mbërritur befasia dhe ngushëllimi i Zotit Jezus të pranishëm në jetën tonë ka kuptim të jetojmë «pa asgjë tonën» (RrP I,1); përndryshe është një varfëri e trishtueshme. «Asgjë tjetër nuk duhet të dëshirojmë, asgjë tjetër të duam, asgjë tjetër të na pëlqejë e të na kënaqë, përveç Krijuesit e Shpërblyesit e Shpëtimtarit tonë, të vetmit Hyj të vërtetë, i cili është e mira e plotë, çdo e mirë, e gjithë e mira, e mira e vërtetë dhe më e madhe, që është i vetmi i mirë» (RrP XXIII,9); do të ishte e trishtueshme, ndoshta do të na thoshte shën Françesku me fretërit e vet të parë,

nëse do të donim "të shisnim gjithçka" pa qenë më parë të pushtuar prej gëzimit për një thesar të tillë, që ka tejkaluar çdo pritshmëri tonën, thesari që është Jezusi, thesari i atij vështrimi pafundësisht simpatik që Biri i Hyjit ia drejton gjithmonë secilit prej nesh, duke nxitur bashkim.

Përshpirtëri dhe jo spiritualizëm

Shpirti i Zotit kërkon përvujtërinë e durimin dhe paqen e pastër e të thjeshtë të shpirtit.
(RrP XVII,15)

Mes "ngjyrave" dhe "tonalitetëve" më tërheqëse të këtij teksti është pa dyshim thjeshtësia e tij. Kujdes: jo banaliteti i një thjeshtësime tepër të lehtë, por inteligjenca e mprehtë e atij që ka gjetur një fill të kuq që është në gjendje të japë qëndrueshmëri, të mbajë gjithçka të bashkuar. Pra ajo që mban së bashku trupin e *Rregullës së pavulosur* duket se është pikërisht qendërsia unitare e jetës në Shpirtin. Çfarë do të thotë kjo? Edhe këtu do të thotë në radhë të parë dialog me jetën! Françesku i Asizit nuk e di që në fillim se çfarë është Shpirti Shenjt dhe si vepron ai, por është toka e ashpër e jetesës së përditshme ajo që e bën ta njohë timbrin e atij që është zëri i Shpirtit. Zëri i Shpirtit ka një timbër të vetin që nuk mund të ngatërrohet dhe është tejet delikat, të cilin shën Françesku ka ditur ta dëgjojë me një vëmendje maksimale feje! Dhe ka bërë që *Rregulla* të mund të ruante dhe të dorëzonte rrugëtime të mira për të gjithë, për të jetuar pikërisht kështu, duke pasur Shpirtin e Zotit. Kështu mund të kemi disa udhëzime të frytshme edhe për ne, pas tetë shekujsh; udhëzime jo spiritualistike, do të thotë jo të caktuara më herët se jeta, ideologjikisht; por shpirtërore, sepse "të kapura" prej dridhjeve

të frymës së Shpirtit në ajrin e thithur duke banuar në mes të njerëzve. Cilat janë këto udhëzime shpirtërore? Të paktën ato më të çmueshmet? Ndoshta mund të përmbliidhen përreth disa pikave nevralgjike:

- *Konkretësi e zakonshme: Rregulla e pavulosur* i zhyt gishtat në brumin e ekzistencës, me tharmet e veta nganjëherë kontradiktore dhe nganjëherë premtuese; sidoqoftë, nuk humbet në saktësimin e normave asketike, dhe shqetësimi i saj më i madh është ai që të kujdeset për jetën, në të gjitha format e saj. Ka për zemër një ecje të jetës! Jo ruajtjen kryeneçe të strukturave. Edhe këtu mund të citohet: nis procese, nuk përvetëson hapësira! (krh. EG 223)
- *Pa dëshirën për duartrokitje*: në një mijë mënyra – dhe nganjëherë, për këtë, duket gati sikur shën Françesku flet duke rënë në gjunjë – jemi të nxitur të kushtojmë vëmendje, me qëllim që të jemi domethënës, po, por jo pre e një domethënshmërie që është prirje për të rënë në sy. Shenjtinë e dinte mirë se sa i hollë dhe tinëzar është kufiri: të gënjejmë veten se “jemi duke jetuar Ungjillin” sepse na ndjekin shumë, na duartrokin shumë dhe kemi shumë *like* apo *followers* në rrjetet tona sociale. Pra, është e nevojshme syçeltësia, sepse «shpirti i mishit dëshiron dhe kujdeset shumë për të pasur fjalë, por pak për t’i vënë ato në jetë, dhe kërkon jo fetarinë dhe shenjtërinë e brendshme të shpirtit, por do dhe dëshiron një fetari dhe një shenjtëri që t’u duket përjashta njerëzve» (RrP XVII,11-12). Nganjëherë, ndoshta, rreziku është ai

që ta quajmë “profeci” atë që është vetëm vitrinë shkëlqyese. Por shën Françesku e dinte këtë: profecia nuk është skenë, dhe kërkon shumë përvujtëri, shumë ankth... nëse jo për tjetër, për faktin se profetët, përgjithësisht, kanë një përfundim të keq.

- *Një humbje e madhe kohe*: janë të begatshme fjalët që përdor *Rregulla e pavulosur* për të bërë që fretërit të mos jenë koprracë në shpenzimin e kohës për lutjen: «Të gjithë ne fretërit, të kemi kujdes me veten, sepse, me pretekstin e ndonjë shpërblimi apo veprë që duhet bërë apo ndihme, të mos na ndodhë ta humbasim apo ta largojmë mendjen dhe zemrën tonë prej Zotit. Por, në dashurinë e shenjtë, që është Hyji, u lutem të gjithë fretërve, si ministrave ashtu edhe të tjerëve, që, pasi të largojnë çdo pengesë dhe të lënë mënjane çdo shqetësim e çdo merak, sa më mirë që të munden, të angazhohen për të shërbyer, për të dashur, për të adhuruar dhe për të nderuar Zotin Hyj, me zemër të dëlirë dhe me mendje të pastër, ajo që ai vetë kërkon mbi çdo gjë tjetër. Dhe gjithmonë të ndërtojmë në veten tonë një banesë për të» (XXII,25-27). Ftesë, kjo, me të vërtetë shpirtërore: ftesë në dhurim falas, në bujarinë për të përjetuar kohë në dukje të pafrytshme por që, në të vërtetë, ushqejnë jetën shpirtërore. Pa këmbënguljen e kësaj besnikërie ndaj lutjes, për shën Françeskun gjithçka rrezikon të bëhet farsë, ose, në rastin më të mirë, përpjekje vullnetaristike pa hare.

Në kundërshtim me «anti-Françeskun». Vetëm si vëllezër!

*Ruajini shpirtrat tuaj
dhe ata të vëllezërve tuaj.
Të gjithë fretërit të mos kenë asnjë pushtet
apo sundim, sidomos mes tyre.
(RrP V,1.9)*

Ashtu siç ka një «antikrisht» (krh. 1Gjn 2,18), po ashtu ka edhe një «anti-Françesk». A është përkushtimi ndaj cilësisë së jetës vëllazërore ai që bën dallimin? Jo vetëm jeta vëllazërore, por me siguri edhe kujdesi apo, në të kundërt, mosinteresimi për ta jetuar atë, krijon një ndryshim. Rregulla e pavulosur nuk i kursen nxitjet në mënyrë që ndjekja e Jezusit të jetohet si vëllezër. Dhe, mund të guxojmë të paraqesim gati njëfarë “dogme”, njëfarë përmbledhjeje në këtë mënyrë: asgjë nuk është aq “anti-françeskane” (por, duhet të themi, antikristiane) se sa një stil jete që largohet nga pasioni për lidhjet vëllazërore, shpirtijetë i të cilave duhet të ruhet!

Françesku duket se ka pikërisht qëllimin që të bëjë të lindë në ne një frikë e shëndetshme për çdo formë mospërfilljeje ndaj tjetrit; dhe harton një mijë ftesa, të marra edhe ato prej rrugëve të jetës, në mënyrë që të mund të ruhet e ndezur në zemër bindja se tjetri është gjithmonë për ne një “borxh”, një zë që na thërret, dikush të cilit nuk mund të mos i kushtojmë vëmendje. Në shumë forma! Disa prej tyre, pas shekujsh, e ruajnë në mënyrë të shkëlqyer gjithë magjepsjen e tyre:

- *Ëmbëlsi pa falsifikime*: një armik kundër të cilit duhet të luftojmë është ai i “turinjve të varur”, i mbylljeve kryeneçe, i qëndrimeve shtirësisht të përvuajtura (por të bezdisshme e të rënda)! «Të ruhen fretërit që të mos tregohen të

trishtuar përjashta dhe të vrenjtur si hipokritët, por të tregohen të gëzueshëm në Zotin dhe të hareshëm e të sjellshëm siç u ka hije» (RrP VII,16). Pra, duhet të buzëqeshim gjithmonë? Nuk është kjo puna! Nuk bëhet fjalë për t’u bërë ekspertë në falsifikimin e lehtë të buzëqeshjeve të shpërndara majtas e djathtas; por do të jetë themelore të mos e lëmë veten të tiranizohemi prej peshave të të ndierit tonë, gjithmonë i lëvizshëm dhe i paqetë. Do t’ia vëmë veshin edhe zemrës sonë kur është e trishtuar, sigurisht, por pa pasur nevojë t’ia plasim në fytyrë tjetrit ashpërsinë tonë hijerëndë.

- *Anestezi përballë “tepër të ndjeshmit”*: shumë herë ka disa “të gërbulur” që duhet t’i takojmë, disa afërsi të ashpra e të vështira që duhet të frekuentojmë. Edhe këtu: *Rregulla e pavulosur* na paralajmëron dhe na fton “të anestezizojmë”, t’i bëjmë të heshtin ato zëra që, brenda nesh, do të na bënin të iknim larg, të distancoheshim. Ndërsa ftesa e drejtuar fretërve është «që të jenë të hareshëm kur jetojnë mes personave të parëndësishëm e të përbuzur, mes të varfërve e të dobtëve, të sëmurëve e të gërbulurve dhe mes lypësve përgjatë rrugës» (RrP IX,2). Kjo detyrë me siguri bëhet më e vështirë kur vëllai prej të cilit nuk duhet të ikim është i varfri: është zëri që i prish planet e mia, është dora e shtrirë që më detyron të gjej rrugë të parrahura bashkimi, janë plagët që nuk do të donim t’i shikonim dhe që na ftojnë të marrim përsipër një ndjeshmëri të re (që nuk duhet anestezizuar, këtë herë!): atë të zemrës së dhimbshme të Jezusit.
- *Një pafytyrësi që duhet rifituar: të mësojmë nga të vuajturit*. Që jeta vëllazërore nuk është një shëtitje e rehatshme dhe romantike është një vetëdije

e pranishme në *Rregullën*. Ajo që të bën përshtypje, në lidhje me jetën vëllazërore, është se edhe vështirësitë e përjetuara, nganjëherë të mëdha, për Françeskun, duhet të pranohen si shanse; ai madje do të thoshte “një hir”! Sfida (dhe këtë herë është me të vërtetë e tillë!) është ajo që të lejojmë të prekemi prej personave që më shumë i druajmë ose që më shumë bezdisin, pa pasur nevojë t’u shmangemi gjithmonë; mund të ndodhë që të arrijmë të mësojmë diçka të re, të paktën një grimcë prej asaj lirie që shijojmë atëherë kur, ndoshta vetëm duke belbëzuar, arrijmë “të vdesim për t’u ringjallur”.

Më pak se ai që ka më pak rëndësi. Për të folur për “minoritetin”

*Dhe askush të mos jetë i thirrur drejtues,
por të gjithë në të njëjtën mënyrë të jenë
të thirrur fretër minorë.
(RrP VI,3)*

Fretërit minorë. Ja emri i pagëzimit që shën Françesku dëshiron t’u japë atyre që zgjedhin t’i besohen kësaj Rregulle dhe të jetojnë sipas saj. Minoritet! Fjalë me një mijë domethënie dhe me aspekte të paimagjinueshme. A është e mundur të gjendet një formulë që i përmbledh të gjitha ato? Të shumta dhe efikase janë përpjekjet e bëra për këtë punë përmbledhjeje. Dhe, pa pretenduar plotësinë, ndoshta mund të hipotizohet se “minoritet” është zgjedhja që të duam të kemi rëndësi “më pak se ai që ka më pak rëndësi”. Kjo po që është profeci! Kjo po që është një bërthamë gati e pamundur për t’u jetuar, por që e ruan të paprekur aftësinë e vet për të na paralajmëruar përballë çdo rreziku madhështie apo zotërimi. A bëhet fjalë për një virtyt?

- Në mënyrë më të drejtë, ndoshta duhet të thuhet se minoritet nuk është edhe aq një

prirje asketike vetmitare, do të thotë një tërësi zgjedhjesh të sjelljeve – me rrezikun që të jenë poshtëruese dhe reduktive; zgjedhje personale, pothuajse në kërkim të një “përsosmërie të brendshme personale”. Por është një mënyrë për të ndenjur në jetë; dhe në këtë kuptim është një mënyrë për të ndenjur në marrëdhënie: me personat, me botën e krijuar, me Hyjin. Minor është ai që nuk lodhet kurrë së pranuari, me gjithë shpirt, se gjithçka që është, vjen prej Hyjit, dhe prandaj nuk mund të mos jetojë në “gjendje mirënjohjeje”.

- Sinodalitet, shoshitje bashkësiore: janë ndoshta ndër shprehjet më të shpeshta në kishën e sotme. E dimë: kur flitet shumë për diçka, ndoshta kjo ndodh sepse ndihet mungesa e saj, nevoja e ngutshme për të. Ose sepse njerëzit kanë frikë të jenë me të vërtetë sinodalë ose druajnë faktin se, duke bërë shoshitje së bashku, gjithmonë duhet të humbasin diçka prej vetes. Termat në fjalë janë moderne; shën Françesku nuk i ka njohur apo përdorur, e megjithatë thirrjet shumë të shpeshta në format e ndryshme të dëgjësës gjejnë hapësirë në *Rregullën e pavulosur* në një sfond dëgjimi dhe shërbimi të ndërsjellë: «për dashurinë që vjen prej Shpirtit, me gjithë qejf t’i shërbejnë dhe t’i binden njëri-tjetrit» (RrP V,14). Minoritet është edhe kjo: nuk jemi ne ata që e prodhojmë personalisht “të vërtetën”, por na dhurohet gjithmonë “nga jashtë”, nga dëgjimi i ndërsjellë «për dashurinë që vjen prej Shpirtit».
- Përmbledhja jetësore dhe efektive e minoritetit ndoshta duhet të shihet në logjikën e shpronësimit, që në *Rregullën e pavulosur* shfaqet i lakuar sipas perspektivave të shumëllojshme e përplotësuese, duke cilësuar të gjitha qëndrimin e një personi që, për vete, nuk mban

asgjë: kthej, dhuroj, jap, lavdëroj, falënderoj, bekoj (RrP XXIII).

Në ekstroversion të shenjtë. Të shkojmë nëpër botë

*Kur të shohin se i pëlqen Hyjit,
të shpallin fjalën e Zotit.
(RrP XVI,7)*

Se i janë dhuruar Zotit, madje, i janë dorëzuar tërësisht atij – «Dhe të gjithë fretërit, kudo që janë, të mos harrojnë se kanë dhuruar vetveten dhe ia kanë dorëzuar trupat e tyre Zotit tonë Jezu Krishti» (RrP XVI,10) – përfaqëson një lëvizje përbërëse në jetën e minorëve, të thirrur të gëzojnë përkatësinë e tyre në Zotin jo veçmas apo duke kërkuar bashkime shpirti vetëm ndërbashkësore (gjithmonë kalimtare); por duke iu përgjigjur ftesës së Zotit që të jenë misionarë, që të përshkojnë rrugët e botës për të shpallur Fjalën e Hyjit. Në *Rregullën e pavulosur* nuk takohen shumë fjalë që shprehin se në çfarë përbëhet predikimi; nuk gjenden udhëzime analitike mbi “gjërat” që duhen thënë. Megjithatë, mund të jemi të sigurtë se në qëllimet e shën Françeskut gjendet dëshira për të favorizuar një predikim të bërë me vepra; para së gjithash nëpërmjet heqjes dorë prej çdo forme pretendimi ndaj atyre pranë të cilëve do të gjendemi. Shpallja e hapur e fjalës së Hyjit mbetet e rëndësishme, por me vetëdijen për përgjegjësinë që të mos tradhetojmë, nëpërmjet stilit të marrëdhënieve tona, Ungjillin e shpallur me fjalë.

Madje, në mënyrë edhe më rrënjësore, ndoshta nuk jemi larg prej së vërtetës nëse vëmë në dukje në *Rregullën e pavulosur* një fakt në vetvete lirues dhe befasues: shumë herë e shpallim Ungjillin pa thënë ose pa bërë,

por duke e pranuar pa hidhërim gjendjen tonë si të varfër, të gjithë të thirrur para së gjithash që të marrim. E shpallim mesazhin e shëlbimit duke dëftuar, në trupin tonë, gjendjen rrënjësore të kufizueshmërisë, që ka gjithmonë nevojë për mëshirë: «Meqenëse të gjithë ne të varfrit e mëkatarët nuk jemi të denjë të të përmendim, me përvujtëri lutemi që Zoti ynë Jezu Krishti Biri yt i dashur, të cilin e ke për zemër, së bashku me Shpirtin Shenjt Mbrojtës, të të falënderojë» (RrP XXIII,5).

PËR TË PËRFUNDUAR

Një vulë që nuk është vënë kurrë

E pavulosur: kjo shprehje shërben për të saktësuar se gjendemi përballë një teksti që nuk ka marrë kurrë vulën e një miratimi zyrtar, nëpërmjet bullës papnore; për shumë arsye. Ndoshta ia vlen të përfitojmë prej kësaj mungese të vulës që ta kujtojmë jo vetëm si të dhënë formale e juridike, por edhe për të vlerësuar rëndësinë e saj ekzistenciale. Pra, duam të falënderojmë Zotin për dhuratën e një dëshmie – më shumë se sa për një tekst – që mbetet “pa kufij”, ende e hapur dhe “gjeneruese”. Në letër, *Rregulla e pavulosur* nuk mund të ketë vazhdimësi, por mund ta gjejë atë në jetën e gjallë të atij që pranon, me «frymëzim hyjnor» (RrP II,1), ftesën për ta jetuar fenë e vet në sintoni me gjenialitetin e shën Françeskut.

Në mes të shumë travajeve të kohës sonë, bashkëndarës të anktheve të shumë burrave e grave në anët më të ndryshme të botës, dëshirojmë gjithsesi ta mbajmë të ndezur flakën optimiste të shpresës së krishterë, duke e pranuar me zemër zellin mirënjohës të shën Françeskut që, mes

mjerimeve të botës, nuk heq kurrë dorë prej bekimit të Zotit «që është i vetmi që është i mirë, i përsipirtshëm, i butë, i këndshëm dhe i ëmbël, që është i vetmi që është i shenjtë, i drejtë, i vërtetë, i paanshëm, që është i vetmi që është dashamirës, i pafajshëm, i pastër, prej të cilit e nëpër të cilin e në të cilin është çdo falje, çdo hir, çdo lavdi» (RrP XXIII,9).


I ftojme të gjithë anëtarët e familjes françeskane që të bashkohen me ne për

të kujtuar ftesën e shën Françeskut, të shprehur qartazi në *Rregullën e pavulosur*, për të jetuar një jetë të udhëhequr prej Shpirtit të Hyjit, të rrënjësuar në përvojën njerëzore e të hapur ndaj dashurisë dhe afërsisë befasuese që Hyji u jep atyre që janë të gatshëm t'i lejojnë Atij të jetë në qendrën e të gjithë jetës.


O Hyj i gjithëpushtetshëm, tejet i shenjtë, tejet i lartë e suprem,
Atë i shenjtë dhe i drejtë,
O Zot Mbret i qiellit dhe i tokës,
ty të falënderojmë!
(RrP XXIII,1)

Romë, 4 tetor 2020

E kremtja e Shën Françeskut të Asizit


FRA MICHAEL A. PERRY
Minister generalis OFM


FRA ROBERTO GENUIN
Minister generalis OFMConv


FRA CARLOS A. TROVARELLI
Minister generalis OFMConv

U lutem të gjithë fretërve ta mësojnë letrën dhe domethënien e gjërave që në këtë jetë kanë qenë shkruar për shëlbimin e shpirtit tonë, si dhe t'i sjellin shpesh në kujtesë (RrP XXIV,1)